

VENDIM
Nr.1293, datë 29.12.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE,
PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 736, datë 8.9.2010)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e *Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit* kryetar të këshillit drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

2. Emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë vijon:

- a) znj. Majlinda Bregu, Ministre e Integritimit;
- b) z. Dritan Prifti, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- c) z. Ferdinand Poni, zëvendësministër i Brendshëm;
- ç) z. Nezir Haldeda, zëvendësministër i Financave.

3. Vendimi nr.688, datë 18.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të FSHZH-së”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha